

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	8 milionë euro për TRANSFORMIMIN e Durrësit, nga Ura e Dajlanit te godina e Kavalishencës, ja si do t ë duket qyteti bregdetar (PAMJE)
ADRESA	https://newsbomb.al/ekonomi/8-milione-euro-per-transformimin-e-durresit-nga-ura-e-dajlan-it-te-godina-i401520
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 09:42:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 09:32:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f2b6b88a9adcab5ba0aa5fa4aebc4352cd065eaca6586731248714e87635b4e6
TEKSTI	9c49bed2699205bac85d84bd5fc98fdf66d886c5c226d94ea729f786ca66eae4
PAMJA	698518cdef47d47d252ce1163e03c4e4af1c4edf76cbf24fd15c47677f5106d7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c49081bbdd16082ba2e58ba063e773363c0eedf01a413b9085290c3f07b5203e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	219f872b2d436154cbce21b1357d2a6f04cc2d43ba2a7914d91c1ebdf0665477
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/c49081bbdd16082ba2e58ba063e773363c0eedf01a413b9085290c3f07b5203e

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#)
[Politikë](#)
[Aktualitet](#)
[Ekonomi](#)
[Kulturë & Art](#)
[Rajon](#)
[Sport](#)
[Bota](#)
[Showbiz](#)
[SocialBomb](#)


Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Ekonomi

18 Shtator 2026, 11:32

8 milionë euro për TRANSFORMIMIN e Durrësit, nga Ura e Dajlanit te godina e Kavalishencës, ja si do të duket qyteti bregdetar (PAMJE)

Shkruar nga Newsbomb



Ilustrim

Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hapur një tender me vlerë rreth 8.5 milionë euro për projektimin e transformimit të vijës bregdetare të Durrësit, një ndërhyrje që synon ta kthejë segmentin nga Ura e Dajlanit deri te godina e Kavalishencës në një hapësirë të re turistike, rekreative dhe urbane.

Kjo nuk është hera e parë që çelet kjo procedurë pasi më herët u publikua në dhjetor 2025 por atëherë fondi limit ishte shumë më i ulët rreth 540 milionë lekë apo rreth 5.5 milionë euro por që më pas u anulua

Sipas dokumenteve të publikuara në sistemin e prokurimeve, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka shpallur procedurën me fond limit 833.2 milionë lekë, në kuadër të fazës së tretë të investimeve për infrastrukturën e tregjeve, hapësirave tregtare dhe zonave model të zhvillimit.

Projekti parashikon ndërhyrje përgjatë një segmenti bregdetar prej rreth 2.8 kilometrash, duke zgjeruar vijën e plazhit deri në 100 metra drejt detit dhe duke krijuar hapësira të reja publike për banorët dhe turistët.

Plani përfshin ndërtimin e një parku linear të gjelbër, shëtitoreve të reja, zonave multifunkionale, infrastrukturës sportive dhe rekreative, si dhe krijimin e të ashtuquajturave "Green Coves", hapësira natyrore që synojnë të lidhin qytetin me detin.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Politikë

Me dorën në Kushtetutë, Ervin Demo BETOHET si ministër i Brendshëm para Begajt



Politikë

Prej më shumë se dy orësh brenda "Vilës së Kuqe", përfundon takimi i Edi Ramës me ministrat dhe drejtuesit politik, çfarë u diskutua (DETAJE)

Zbulu më shumë artikuj >

Në projekt janë parashikuar gjithashtu bare plazhi, restorante, hapësira pushimi, qendra informacioni për turistët, zona pikniku, qendra shëndetësore, parkime për biçikleta dhe platforma për aktivitete tregtare sezonale.

Një pjesë e rëndësishme e ndërhyrjes lidhet edhe me zhvillimin e hapësirave publike për aktivitete kulturore. Projekti përfshin ndërtimin e disa amfiteatrove në natyrë, të konceptuara për koncerte, aktivitete artistike dhe evente publike përgjatë bregdetit.

Zona do të pajiset edhe me struktura sportive, përfshirë fusha tenisi, volejboli plazhi, futboll, një skate park, palestër në ambient të hapur dhe platforma për yoga, ndërsa përgjatë vijës bregdetare janë planifikuar edhe kulla vrotimi për sigurinë e pushuesve.

Dokumentet parashikojnë gjithashtu krijimin e baseneve ujore dekorative, shtigjeve këmbësore me konfigurim organik, sipërfaqeve të gjelbra me pemë mesdhetare dhe zonave të dedikuara për aktivitete komunitare.

Në segmentet e ndryshme të projektit do të ndërtohen hapësira për shërbime publike, tualete, pika ndihme mjekësore, ambiente për marrjen me qira të pajisjeve sportive ujore, përfshirë Jet Ski, si dhe platforma për shërbime tregtare.

Sipas dokumenteve të tenderit, zona e ndërhyrjes shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 544 mijë metrash katrorë, nga Porti i Durrësit deri te Kavalishenca, një nga hapësirat me intensitetin më të lartë të përdorimit urban dhe turistik në vend.

Sipas dokumenteve synohet që investimi të rrisë ofertën turistike dhe të përmirësojë funksionalisht dhe estetikisht bregdetin, duke e integruar atë me infrastrukturën ekzistuese të qytetit dhe me funksionet tregtare, rekreative dhe publike./ Revista Monitor



Fig. 44. Render 3



Fig. 45. Render 4





Fig. 42. Render 1



Fig. 43. Render 2





Fig. 2. Pika referimi për zonën në studim.




Fig. 1. Evidentimi i zonës në studim.

Galeria fotografike ()



Fig. 44. Rendi: 3



Fig. 45. Renditë 4

Sondazh

Poll

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.